



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

**Lënda:** *Sugjerime mbi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, nismë e deputeteve Eglantina Gjermani dhe Klotilda Bushka.*

**Z. ULSI MANJA**  
**KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT.**

*Për dijëni:*

**Z. GRAMOZ RUCI**  
**KRYETAR**  
**KUVENDI I SHQIPËRISË**

**I nderuar Z. Manja,**

Në vijim të kërkesës Tuaj, për të dhënë opinionin në lidhje me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, nismë e deputeteve Eglantina Gjermani dhe Klotilda Bushka, si dhe amendamentet e propozuara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u konsultua mbi këtë projektligj, jep mendimin e tij si më poshtë:

**I) Në lidhje me ndryshimet e propozuara për nenin 130/a “Dhuna në familje”.**

Komisioneri përgëzon nismën e ashpërsimit të dënimeve, me ndryshimet e propozuara për nenin 130/a “Dhuna në familje”, ndodhur në kushtet kur raportohen gjithmonë e më shumë raste të dhunës në familje. Propozimi bëhet akoma me i dobishëm sidomos në kohën e

vendosjes së masave kufizuese nga ana e Qeverisë për shkak të virusit, ku vihet re se politikat e izolimit çojnë në rritje të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave, përfshirë Dhunën në Familje ose siç njihet ndryshe Konventa e Stambollit, vazhdon të zbatohet për të gjitha palët, edhe në kohë pandemie dhe me shume se çdo herë nevojitet zbatimi i standarteve të përcaktuara në këtë Konventë. GREVIO<sup>1</sup>, i ka bërë thirrje të gjitha palëve, që të bëjnë çmos për të siguruar vazhdimësinë në ofrimin e shërbimeve dhe vazhdimin e ofrimit të mbështetjes dhe mbrojtjes për gratë dhe vajzat në rrezik dhune, me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatëse si: agjensitë e zbatimit të ligjit, shërbimet sociale, sektori i drejtësisë, shërbime të specializuara mbështetëse dhe të gjitha ministratë përkatëse.

**II) Në lidhje me propozimet e parashikimit të dy figurave të reja penale përkatësisht shtimi i neneve 242/1 “Mosbindja ndaj masave të organeve kompetente shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe 242/2 “Shkelja e rregullave të karantinës për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive”.**

Institucioni i Komisionerit, ka ndjekur me vëmendje situatën e krijuar në Republikën e Shqipërisë për shkak të virusit COV-19 ku masat e marra nga institucionet përgjegjëse kanë ndihmuar në parandalimin dhe përhapjen e epidemisë dhe kanë qënë në raport të drejtë me kërcënimin që përbën përhapja e virusit. Këto masa shtrënguese kanë kontribuar jo vetëm në ndërgjegjësimin e qytetarëve për ti zbatuar ato, por dhe në uljen e kurbës së përhapjes së pandemisë.

Komisioneri ka vëzhguar se pjesa më e madhe e qytetarëve është e ndërgjegjësuar, por edhe ato raste të cilët thyjnë aktet normative të Këshillit të Ministrave, në të shumtat e tyre, janë për shkaqe ekonomike të pamundësisë për të siguruar të ardhura, nga të moshuar të cilët jetojnë vetëm apo persona të cilët nuk janë të informuar për shkak të kushteve social ekonomike

Duke vlerësuar angazhimin dhe shpejtësinë Tuaj, për të përballuar në kohë situatat, paraparakisht bëj me dije shqetësimin në lidhje me kohën e shkurtër në dispozicion për të shprehur një opinion si dhe mungesën e një Relacioni shoqëruar të plotë dhe shterues në lidhje me argumentimin e veprës së re penale, si dhe procedurën e përshpejtuar të miratimit të këtij projekt ligji.

Në lidhje me këtë të fundit Komisioneri sjell në vëmendjen Tuaj, Nenin 83 paragrafi 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, i cili ndalon zbatimin e procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin e projektligjeve të renditura në nenin 81/2, me përjashtim të parashikimit të pikës, “dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme”. Gjithashtu, në vazhden e kësaj, Komisioneri sjell në vëmendje

<sup>1</sup> Deklarata e presidentit të GREVIO të datës 24 mars 2020: <https://rm.coe.int/grevio-statement-covid-24-march-2020/pdfa/16809cf55e>

edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.5 datë 05.02.2014, e cila në interpretim të dispozitave kushtetuese ka konfirmuar mos ndërmarrjen e procedurave të përsheptuara në lidhje me ligjet e parashikuara në Nenin 81/2 K.Sh. (pika 49 e Vendimit e më tej).

**Në lidhje me thelbin e veprave penale të reja të propozuara parashtröjmë si më poshtë:**

- Në lidhje me parashikimin e shtimit të Nenit 242/1 Komisioneri shpreh opinionin e tij pozitiv mbi nevojën e të pasurit një dispozitë të posacme në lidhje me rregullimin dhe respektimin e kufizimeve të vendosura në kohën e marrjes së masave të jashtëzakonshme për shkak të vendosjes së gjëndjes së jashtëzakonshme dhe asaj të fatkeqsisë natyrore. Propozimi paraqitet i qartë dhe proporcional me synimin e vendosur.
- Në lidhje me parashikimin e Nenit 242/2, Komisioneri shpreh shqetësimin e tij për përmbajtjen e këtij propozimi:

*Së pari*, dispozita, në tërësinë e saj, nuk garanton parimin e proporcionalitetit. Paragrafi i parë i dispozitës parashikon një vepër penale, e cila, në fakt, parashikon të njëjtën figurë veprë penale si kundravajtjet penale të parashikuara nga nenet 242 dhe 242/1 të Kodit Penal. Në këto kushte do të duhej që dhe masa e dënimit të ishte me gjobë ose burgim 3 deri 6 muaj sic parashikojnë këto dispozita. Një qasje e tillë ndëshkimore, ka krijuar disproporcione midis sanksioneve të dispozitave të ndryshme të Kodit Penal të cilat parashikojnë pothuaj të njëjtën figurë të veprës penale.

Nga ana tjetër, dispozita referon si një subjekt të posaçëm të veprës penale, personat mbartës ose jo të sëmundjes infektive ngjitëse. Konsiderimi i këtyre dy grupeve, (grupi i mbartësve të sëmundjes infektive ngjitëse dhe grupi i jo mbartësve të sëmundjes infektive ngjitëse ), të cilët ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme, përballë të njëjtës ashpërsi dënimi, është joproporcionale në raport me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej secilit prej tyre. Në përputhje me kërkesat e parimit të proporcionalitetit, çdo dënim duhet të jetë në raport të drejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe shkallën e fajit të autorit, i cili rezulton i ndryshëm tek personat mbartës dhe ata jo mbartës të sëmundjes infektive ngjitëse.

*Së dyti*, konsiderimi i këtyre dy grupeve, (grupi i mbartësve të sëmundjes infektive ngjitëse dhe grupi i jo mbartësve të sëmundjes infektive ngjitëse), të cilët ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme, përballë të njëjtës ashpërsi dënimi, përbën njëkohësisht edhe cënim të barazisë substanciale e cila bazohet në premisën se rastet e ndryshme duhet të trajtohen në mënyrë të ndryshme, në proporcion me dallimin midis tyre.

Personi që nuk mund të jetë shkaktar i konsumimit të rrezikut që propozimi parashikon sipas nenit 242/2, nuk mund t'i atribuohet përgjegjësi penale, por ai është përgjegjës për shkeljen e urdhërave apo rregullave sipas nenit 242/1.

**Së treti**, dispozita paraqitet e paqartë dhe shumë e gjerë në kuptim dhe interpretim duke lënë mundësi abuzimi nga organet ligjzbatuese dhe diskrecion të pakufizuar interpretimi për pushtetin gjyqsor.

**Së katërti**, Komisioneri propozon të qartësohen pasja apo jo dijëni e personit bartës të një epidemie si dhe shkelja e urdhërave dhe rregullave të karantinës me dashje apo pa dashje, pasi cdo situatë e tillë do të kërkonte parashikime të ndryshme e nuk mund të trajtohen të gjitha në të njëjtën mënyrë sepse cenojnë parimin e barazisë.

**Së pesti**, në lidhje me parashikimin e dënimit të njëkohshëm me gjobë dhe me burgim deri në dhjetë vjet. Gjykata Kushtetuese ka trajtuar problematikë të ngjashme nëpërmjet vendimit nr.47 datë 26.07.2012 dhe ka konstatuar se parashikimi i njëkohshëm i dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë, vjen në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe si të tilla duhen shfuqizuar. Në vijim, nëpërmjet Vendimin nr.77 datë 04.12.2017, Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar se ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të saj është i tillë që u imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të tyre. Në referim me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese, rekomandojmë ndryshimin e këtij parashikimi në përputhje me vendimmarrjen e kësaj Gjykate.

Komisioneri dëshiron të sjelle në vëmendje tri parametrat e mekanizmit ligjvënës ndërhyrës që janë : (i) nevoja; (ii) përshtatshmëria; (iii) domosdoshmëria, të cilat i imponojnë ligjvënësit të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në ashpërsinë e dënimit si dhe të aplikojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, pra ashpërsia e dënimit të jetë e zgjedhur në mënyrë të tillë që të jetë të përshtatshme për parandalimin e veprave penale.

Rëndësi të veçantë në fushën penale, sidomos në atë të parashikimit të dënimeve dhe ekzekutimit të tyre, zë mbrojtja e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se edhe pse prej kohësh e drejta penale ka detyrën e mbrojtjes së bazave të një bashkëjetese të rregulluar në shoqëri, ajo nuk është mjeti kryesor i mbrojtjes ligjore, me gjithë karakterin e saj më të fuqishëm<sup>2</sup>.

Duke qenë se vepra penale e propozuar në vetvete, pavarësisht situatës që parashikon të mbrojtje, është e ngjashme me vepra penale të ndodhura në Kodin Penal aktual, Kuvendi mund të shikojë mundësinë e mos konsiderimit të këtij propozimi ose rikonsiderimit të tij brenda parimeve kushtetuese.

Në funksion të kësaj të fundit, Komisioneri, sugjeron qartësimin e dispozitës 242/2 si dhe zbutjen e masave të dënimit te nenit 242/2, duke konsideruar dallimin midis subjekteve mbartës ose jo mbartës të sëmundjes infektive ngjithëse, në raport me zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe në respektim të parimit të barazise substanciale.

---

<sup>2</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese 09/2015

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,**

**ROBERT GAJDA**

**KOMISIONER**